



RAPORT AUDITIMI (TEMATIK)

BASHKIA PATOS

(Auditim Financiar, pasqyrat financiare 2021)

Tiranë, 2022

 **PËRMBAJTJA:**

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMbledhja Ekzekutive	4 - 10
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimitit í í í í í í í í í í í í í í í í	4 – 5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveí í í í í í í í í í í í í	5 – 6
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimitit í í í í í í í í í í í .	6 - 8
II	HYRJA	8 – 12
	a. <i>Objektivat e auditimit.....</i>	
	b. <i>Qëllimi i auditimit.....</i>	
	c. <i>Identifikim i çështjes.....</i>	
	d. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	f. <i>Kriteret e vlerësimit</i>	
	g. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	h. <i>Metodat e auditimi</i>	
	i. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12 - 28
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	12 - 13
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	13 - 28
2.1	<i>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 202</i>	13 – 28
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIME	28 – 29
V.	ANEKSE	29 - 50

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave.
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve.
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 13.6.2022 deri në datë 23.6.2022, realizoi auditimin financiar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Patos, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në hartimin e pasqyrave financiare viti 2021.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Patos për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një opinion të *pamodifikuar, me "Theksim çështjeje"*, për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2021).

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.1. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llog. 468 <i>Debitorë të ndryshëm</i> , për vitin 2020 paraqitet në vlerën 14,297,594 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 14,298,576 lekë , e cila përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Nga analiza e llogarisë u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë koordinuar punën ndërmjet tyre mbi pasqyrimin e gjendjes debitore të subjekteve fizik/juridik dhe	I lartë	13-28	Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara për të detyrimeve për taksa/tarifa vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë deri më 31.12.2021 në vlerën 136,906,723 lekë , sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>abonentëfamiljar për vlerën 136,906,723lekë, gjendje 31.12.2021. Pra kemi një nënvlerësim të llog. 468 <i>“Debitorë të ndryshëm”</i> në vlerën 136,906,723 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 05, datë 21.2.2022 <i>“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3; urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 8 “Të ardhurat”, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.</i></p>			
	<p>Nga auditimi, rezulton se sipas të dhënave të QKB, Bashkia Patos paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të ÷U.....ö ShA me NUIS ÷J63.....B dhe numër aksionesh 1,000 me vlerë nominale 14,530 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 14,530,000 lekë.</p> <p>Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në Pjesëmarrje të Bashkisë Patos në ÷Ujësjellës Patosö ShA. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të pasqyrave financiare të viteve 2020 dhe 2021, më konkretisht në llog. 26 <i>“Pjesëmarrje në kapitalet e veta”</i>, veprime në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 <i>“Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”</i> me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 <i>“Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale”</i> pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 <i>“Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje”</i> Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesëmarrje me vlerë kontabël 14,530,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.</p>	I lartë	13-28	<p>Drejtorja e Financës të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ÷U.....ö ShA me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 <i>“Pjesëmarrje në kapitalet e veta”</i> dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.</p>
	<p>Llog. 466 <i>“Kreditorë për mjete në ruajtje”</i>, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 28,878,324 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,392,300 lekë, për 41 subjekte të cilat përfaqësojnë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Gjatë vitit 2021 shteta janë në vlerën 10,775,298 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 9,261,321 lekë për 12 subjekte. Nga analiza e llogarisë u konstatua se për 26 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga bashkia, në vlerën 4,186,584 lekë të garancisë së punimeve sipas aneksit nr.11, pika 3, bashkangjitur Raport</p>	I lartë	13-28	<p>Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Auditimit nuk është bërë likuidimi i vlerës së mësipërme të garancisë, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit.</p> <p>Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likuidimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interespublik të këtyre fondeve, në rastet kur në objekt janë konstatuar parregullsi të cilat nuk janë riparuar nga kontraktori, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 05, datë 21.2.2022 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50.</p>			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të vitit 2021, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një *Opinion i pamodifikuar, me "Theksim çështje"*, pasi ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që konstatohet se nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.

Opinion i mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Patos për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dheshënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

"Sipas opinionit tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me kuadrin rregullator për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi "Theksimi i Çështjes".

Baza për opinionin:

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705¹, dhe ISSAI 1200², pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi 5 Theksimi i Çështjesö.

Theksimi çështjeje:

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, është mbivlerësuar për vlerën 4,186,584 lekë, në fund të vitit 2021;

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, është nënvlerësuar për vlerën 14,530,000 lekë, në fund të vitit 2021;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Patos:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Patos janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme³, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve nga auditimi

³ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përse i takon gjetjeve të tij/saj.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òMbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Patos në bazë të programit të auditimit nr. 568 prot., datë 8.6.2022 dhe autorizimit nr. 568/3 prot., datë 8.6.2022, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me afat auditimi nga data 13.06.2022 deri në datën 23.06.2022, për pasqyrat financiarë të vitit 2021, u krye auditimi òAuditim Financiar dhe Përputhshmërieò nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K.GJ**, (*Përgjegjës grupi*)
2. **H.I**, (*Auditues*)

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Patos.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ⁴, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur tre zonat e llogarive, 600 òPagaò, 602 òShpenzime operativeò dhe 230- 231 òInvestimeò.

a- Objektivat dhe qëllimi:

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

b. Identifikimi i çështjes

Projektraporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Patos, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, R.B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe M.SH., Drejtore e Drejtorisë së Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrin ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër

⁴ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

vetëqeverisjen vendore, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *oPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSHö*, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër menaxhimin financiar dhe kontrollinö*, etj.

d. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Patos, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

f- Kriteret e vlerësimit.

- ✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *oPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö*.
- ✓ Rregullore e Brendshme *oMbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-sëö*, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar.
- ✓ Rregullore e Brendshme *oMbi Procedurat e auditimit në KLSHö*, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020.
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar.
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Manualet e Auditimit Financiar të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit.
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *oPër financat e vetëqeverisjes Vendoreö*.
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 *oPër procedurat standarte të monitorimit të*

buxhetit te Njësive te vetëqeverisjes vendore, i ndryshuar.

✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006”*.

- Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.2.2022 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*.

g- Standardet e auditimit:

✓ ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

✓ ISSAI 2000-2899 *“Udhëzues të Auditimit Financiar”*.

✓ ISSAI 2300 *“Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”*.

✓ INTOSAI GOV 9100 *“Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”*.

✓ INTOSAI GOV 9110 *“Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme”*.

-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH^{ss}; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

h- Metodatat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 *“Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për tju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

i-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon⁵.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektiveve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektive fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

j- Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në

⁵Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

2.1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Patos

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Fier, në jug me Bashkinë Mallakastër dhe në lindje me Bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia e re Patos ka një popullsi prej 22.959 banorësh, ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banues 42.738 banorë. Territori i Bashkisë së re është vetëm 82.5 km². Në bazë të të dhënave të regjistrin civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km² ndërsa në bazë të censurit densiteti i popullsisë është 278.3 banorë për km².



Të dhëna të tjera: Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si òPatos-Marrinzaò është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.

Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka

ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka zona të largëta me qendrën e Bashkisë, popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje.

Kuadri ligjor:

Bashkia Patos e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.

Kryetar i Bashkisë Patos është R.B. dhe Këshilli Bashkiak përbëhet nga 21 anëtar.

2.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:

2.2.1. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021.

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese **õBashkia Patosõ** për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 **õPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, i ndryshuar.** Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Fier si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program **õExcelõ**
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu; dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimit e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet

ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjëse, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar për vitin 2020 dhe vitin 2021.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe të analizuar përsa i përket aseteve e ish-Komunave. Ndërsa detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përskruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur**

saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020-2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është 1,366,998,330 lekë dhe për vitin 2020 është 1,136,964,885 lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas Aneksit nr. 1 pika 3 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

A. Aktivet.

Për vitin 2020 dhe 2021

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; **llogaria 520** *“Disponibilitete në Thesar”*, në pasqyrat financiare është në vlerën **200,999,763 lekë** për vitin 2020 dhe në vlerën **268,943,196 lekë**. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Fier, kjo llogari është e analizuar sipas tabelës vijuese.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2020	2021
1	Llogaria 520 <i>“Disponibilitete në thesarö</i>	200,999,763	268,943,196
2	Llogaria 466 <i>“Kreditorë për mjete në ruajtjeö</i>	28,878,323	30,392,300
3	Llogaria 85 <i>“Rezultati i veprimtarisë së ushtrimitö</i>	172,121,440	238,550,896

- Llogaria 520 *“Disponibilitete në Thesar”* është e rakorduar **me të dhënat** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, duke pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor në vlerën 200,999,763 lekë për vitin 2020 dhe në vlerën **268,943,196 lekë për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.**

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë 31 *“Materialeö*, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,236,649 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 1,770,607 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë 32 *“Inventar i imëtö* në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 20,674,975 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 22,950,536 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3.Nënrubrika, llogari të arkëtueshme, gjendja e llogarisë 468 *“Debitorë të ndryshëmö* në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 14,297,594 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 14,298,576 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontroleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021. Në mënyrë analitike paraqitet në

aneksin nr.2, bashkëlidhur Projekt raportit të auditimit.

Titulli gjetjes 1: *Mos kontabilizimi i vlerës debitore të subjekteve private dhe familjar, për mos pagimin e taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 136,906,723 lekë*

Situata:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2020 paraqitet në vlerën 14,297,594lekë dhe me 31.12.2021 paraqitet në vlerën 14,298,576 lekë e cila përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

Sektorit i të ardhurave dhe tarifave vendore dhe Drejtoria e Financës nuk kanë koordinuar punën ndërmjet tyre mbi pasqyrimin e gjendjes debitore të subjekteve taksapagues privat dhe familjar, në vlerën 136,906,723lekë gjendje 31.12.2021. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 Debitorë të ndryshëm në vlerën 136,906,723 lekë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në akt konstatimin nr. 1 datë 25.0.2022. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1. A.M., me pozicion ish përgjegjës sektori, aktualisht Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, në Bashkinë Patos;
2. M.SH., me pozicion Drejtore e Drejtorisë së Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues (NZ).

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë:

Ligjin 10296 datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Urdhri nr.64 datë 22.07.2014 Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 Të ardhurat, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës UMF nr. 08, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli II, pika 6.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitet 2020-2021 të llogarisë 468 Debitorë të ndryshëm si dhe nuk janë pasqyruar debitorët e subjekteve private dhe tarifave vendore në vlerën prej 136,906,723 lekë.

Shkaku:

Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitin 2021 në vlerën 136,906,723 lekë sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.
- Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve

pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

1.Nënrubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 359,386 lekë, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 305,478 lekë, (836,000 ó 530,522) = 305,478 me diferencë në ulje në vlerën 53,908 lekë e cila përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur për vitin 2021. Kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr. 3 pika 3 për projektet, òStudimet e kërkime dhe vlerat përkatëseò, gjendje më 31.12.2021.

2.Nënrubrika, aktive afatgjata materiale

-Gjendja e llogarisë **210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën neto 3,486,492 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën neto 3,321,167 lekë (4,220,846 -908,679). Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas aneksi nr. 4, òToka, Troje, Terreneò, Pasqyrat Financiare, viti 2021 bashkëlidhur Projekt raportit.

-Gjendja në llogarinë **212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën neto 546,652,775 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 547,911,628 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, peksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Në mënyrë të detajuar llog 212 òNdërtime e konstruksioneò është analizuar sipas aneksi nr.5, bashkëlidhur Projekt raportit.

-Gjendja në llogarinë **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën neto 84,516,725 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 80,290,890 lekë (93,442,926 ó 13,152,036), e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. Në mënyrë të detajuar llog **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** është analizuar sipas aneksi nr.6, bashkëlidhur Projekt raportit.

-Gjendja e llogarisë **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën neto 5,782,877 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 7,415,385 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe peksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të detajuar është analizuar sipas inventarit fizik.

-Gjendja e llogarisë **215 “Mjete transporti”** më 31.12.2020 paraqitet në vlerën neto 9,510,308 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 3,787,446 lekë. Në mënyrë të detajuar llog **215 “Mjete transporti”** është analizuar sipas aneksi nr.7, bashkëlidhur Projekt raportit.

-Gjendja e llogarisë **218 “Inventar ekonomik”**, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën neto 46,991,944 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 40,529,442 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe paksime gjatë vitit 2021, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Për vitin 2021 gjendja e llogarisë **219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”**, amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc,

pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 për tatim mbi të ardhurat, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme të ndryshuar. *Më hollësisht trajtuar në aneks nr. 8 bashkëlidhur Projekt raportit.*

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 dhe Huadhënie e nën huadhënie dhe 6 pjesëmarrje në kapitalin e vetë, më 31.12.2020 dhe më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi i vlerës monetare 14,530,000 lekë, në llogarinë 26 Aktive afatgjata financiare si aksionare me 100% të aksioneve të U..... SHA me NUIS 0J63.....Bö

Situata: Për vitet 2021 rezultoi se: Bashkia Patos, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të U..... SHA me NUIS 0J63.....Bö e cila është shoqëri aksionare me objekt shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 14,530 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 14,530,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Patos në U..... SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021, më konkretisht në llogarinë 26 pjesëmarrje në kapitalet e veta, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje. *Përsa me sipër, ngarkohet me përgjegjësi: Xh. Gj., në cilësinë e Përgjegjëses së Kontabilitetit për periudhën 2020-2021.*

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar, me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale, pika 55, 56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformimi i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar viti 2020 dhe 2021, të llog 26 pjesëmarrje në kapitalet e veta, çka ka sjell një nënvlerësuar të llog 26 në vlerën 14,530,000 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi.

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandimë:

Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek U..... Sh.a me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

4.Nënrubrika, investime.

-Gjendja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 186,227,456 lekë, në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 336,104,052 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ÷Aktive afat gjata materialeö. Në mënyrë të detajuar llog 231 “Për aktive afatgjata materiale” është analizuar sipas aneksi nr.9, bashkëlidhur Projekt raportit.

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme. gjendja e llogarive të 401-408 ÷Furnitorë dhe llogari të lidhura me toö , të 42 ÷Personeli e llogari të lidhura me toö, -të 431 ÷Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksaö, të 435 ÷Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreö, të 436 ÷Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreö, janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 ÷Operacione me shtetinö në vlerën 16,227,939 lekë për vitin 2020 dhe në vlerën 39,379,075 lekë për vitin 2021 të analizuar me vlerat e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2020	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli llogaria 42	7,066,658	8,998,929
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	548,172	576,789
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,656,022	2,697,661
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	362,006	368,319
5	Furnitorë llogaria.401-408	4,386,277	25,344,587
6	Kreditorë të ndryshëm	1,208,804	1,392,790
	TOTALI	16,227,939	39,379,075

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë 4342 ÷Operacione me shtetin, të drejtaö dhe vlerës të pasqyruara në 6 (gjashtë) llogarive pasive, pra në vitin 2020 dhe 2021, është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja e llogarisë 401-408 ÷Furnitorë e llogari të lidhura me toö, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 4,386,277 lekë dhe në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 25,344,587 lekë për 19 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor të likuidimit të detyrimeve në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.05.2022, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20.Në mënyrë të detajuar llog 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, është analizuar sipas aneksi nr.10, bashkëlidhur Projekt raportit.

Titulli gjetjes 2:Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Situata:

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 28,878,324 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,392,300 lekë, për 41 subjekte të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme.Gjatë vitit 2021 shesta janë në vlerën 10,775,298 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 9,261,321 lekë për 12 subjekte. Nga analiza e kësaj llogarie,konstatohet se:

a) Për 26 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 4,186,584 lekë, sipas aneksit nr.11, pika 3, nuk është bërë zhbllkimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar

në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50.

Pika 30. "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet",

Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizime dhe pjesën e grandit që trashëgohet)",

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, Kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: *UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 Kap. III, pikat 30, 50.*

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 466 òKreditorë për mjete në ruajtje

Shkaku:

Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 òKreditorë për mjete nën ruajtje, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

-Testimi i llogarisë 600 "Pagat dhe shpërblime"

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiakë nr.52 datë

18.12.2020. Miratuar në total numri 224 + 5 punonjësit të Gjendjes Civile gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 217 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve. Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos, është miratuar me Urdhër të Kryetares të Bashkisë; për vitin 2019 nr.40 datë 04.01.2019, për vitin 2020 nr.3481 datë 24.12.2019 ,si dhe për vitin 2021 nr.1 datë 06.01.2021.

Sipas listë pagesave të muajve Janar 2019, Shkurt 2020 dhe Gusht 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Specialiste e pagave, Drejtoresha e Financës, dhe Kryetare e Bashkisë.

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2019- 31.12.2021.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Prill-Shtator 2021) dhe konstatohet se ato plotësohen konformë rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga Titullari i Bashkisë. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Patos, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos, është miratuar me Urdhër të Kryetares të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Prill-Shtator 2021) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues. Listë pagesat janë të firmosura nga Specialiste e pagave A.H., Drejtoresha e Financës M.SH. dhe Kryetare e Bashkisë R.B..

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Specialiste e pagave A.H., Drejtoresha e Financës M.SH. dhe Kryetare e Bashkisë R.B..

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtoresha e Burimeve Njerëzore J.SH. dhe nga Kryetare e Bashkisë R.B..

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, në Bashkinë Patos nuk është bërë asnjë ndalesë tjetër.

Paraqitja në formë tabele e burimit të Financimit.

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transfertë specifike
Viti 2021	148,734	133,849	89	38,784	31,404	5,260	58,399

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 31/12/2021		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	148,734	133,849	89
2	F. Sig. Shoq	24,768,275	21,353	86

3	F. Veçantë	3,339	1,919	57
---	------------	-------	-------	----

***Saktësia e plotësimit të Urdhër shpenzimeve.**

. Për vitin 2021, u audituan urdhër shpenzimet e muajit Prill nga nr. 122 deri te urdhër shpenzimi nr. 179 dhe për muajin Nëntor nga nr. 514 deri te urdhër shpenzimi nr. 546. Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues.

Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

*Për rastet e likuidimit të punimeve të ndërtimit, urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhri për ngritjen e KVO-së, formulari njoftim fituesi, buletini i APP për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate, kontrata e lidhur midis palëve, situacioni i punimeve të kryera, fatura e TVSh së subjektit përfitues, certifikata e përkohshme ose përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve, akt kolaudimi përfundimtar.

*Për rastet e blerjeve të materialeve të ndryshme, urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhër për ngritjen e KVO-së, fotokopje e buletinit të APP për njoftim fituesi dhe njoftim për lidhje kontrate, fotokopje e kontratës së lidhur midis palëve, fatura e subjektit përfitues, proces verbali i marrjes në dorëzim dhe numri i fletë hyrje e magazinës.

*Për rastet e likuidimeve të shërbimeve e konkretisht të shërbimit të pastrimit të qytetit, të shërbimit të gjelbërimit, të shërbimit të varrezave të qytetit, të shërbimit të trotuareve, urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur dokumentet si Situacioni i punimeve të kryera në fakt, fatura e TVSh së subjektit përfitues, kontrata e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit, proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve e shërbimeve.

Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar. Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme. Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël dhe janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Patos

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: për vitin 2021 struktura organizative është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 52 datë 18.12.2020. Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Patos nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, por është caktuar një specialist në Drejtorinë e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban si dhe me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë për krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njesisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patos janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.).

Bashkisë Patos, me VKM nr. 443, datë 15.06.2016 për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Patos, të Qarkut Fierë, i është miratuar lista

inventarit dhe përfundon me numër rendorë 300.

Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë òPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosë grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësisë Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 100 (njëqind) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 1700 (njëmijë e shtatëqind) miratuar me VKB nr. 52, datë 04.11.2021, dërguar ASHK ósë Fier me shkresën nr.2881 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Ish Komunës Rruzhdie, sot Njësia Administrative Rruzhdie me VKM nr. 432, datë 15.05.2013 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Zharrëz, të Qarkut Fierò, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 865. Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë òPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosë grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësisë Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 54 (pesëdhjetë e katër) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 902 (nëntëqind e dy) miratuar me VKB nr. 50, datë 04.11.2021, dërguar ASHK ósë Fier me shkresën nr.2883 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Ish Komunës Zharrëz sot Njësia Administrative Zharrëz e Bashkisë Patos, me VKM nr. 558, datë 27.07.2016 òPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësia Administrative Zharrëzò, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 178. Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë òPër krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patosë grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësisë Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 20 (njëzetë) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 201 (dyqind e një), miratuar me VKB nr. 51, datë 04.11.2021, dërguar ASHK ósë Fier me shkresën nr.2882 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Përsa sa më sipër Bashkia Patos ka krijuar regjistrin e aseteve por nuk i ka regjistruar në kontabilitet pasi me shkresat e sipërcituara janë dërguar në (ASHK), për vazhdimin e procedurave të mëtejshme mbështetur në nenin 8, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 òPër pronat e paluajtshme të shtetitò, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 òPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetëroreò, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 òPër inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendoreò, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 òPër mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publikeò Në mënyrë të përmblodhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si vijon:

Nr.	Bashkia/ Njësite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2019	Nr. Praktikave të Certifikuara 2019-2021	Prona te pa Riregjistruara
1	Zharrëz	178	0	2	176
2	Patos	300	0	15	285
3	Ruzhdie	865	0	1	864 *
Numri i pronave sipas inventarizimit fizik dhe të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të dërguara në ASHK, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin përfundimtar dhe çertifikimin e tyre.					
1	Zharrëz	201			Në Proces
2	Patos	1700			Në Proces
3	Ruzhdie	902			Në Proces

- Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Patos të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyje dhe kullota publike ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se në zbatim të ligjit Nr.9385 datë 04.05.2005 òPër Pyjet dhe Shërbimin Pyjorò, ligjit Nr.111/2018 òPër Kadastrënò dhe VKM Nr.433 datë 08.06.2016, Ministria Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit dhe kompanisë së kontraktuar CSI-Piemonte & Datech, me mbështetjen e Bankës Botërore, Qeverisë Suedeze dhe Fondit për Mjedis Global, filloi òRegjistrimin Fillestar të Pasurive të Tipit Pyje dhe Kullotaò në pronësi/administrim të Bashkisë Patos.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit me shkresën nr. 11423 prot. date 30.12.2019 ka njoftuar Bashkinë Patos mbi òProcesin e regjistrimit fillestar të pasurive të tipit Pyje dhe Kullotaò, në pronësi të Bashkisë Patos. Në vijim të korrespondencës Bashkia Patos me shkresën nr.12/3 prot. datë 28.02.2020 i dërgoi informacion Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, mbi procesin e òRegjistrimit fillestar të pasurive të Tipit Pyje dhe Kullotaò në pronësi të saj, bashkëlidhur vendimin e Këshillit Bashkiak nr.4 datë 04.02.2020 si dhe listën e inventarit të pasurive Pyje dhe Kullota e cila fillon me numër rendor 1-42 faqe 2, konfirmuar me shkresën nr.188/1 prot. datë 14.02.2020 të Prefektit të Qarkut Fier mbi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Patos.

Me shkresën nr. 5 prot. datë 25.08.2020, kompania CSI Piemonte & Datesh i është drejtuar Bashkisë Patos, Drejtorisë Vendore të ASHK Fier për takim konsultativ dhe diskutim mbi kufijtë Kadastral në të cilat po kryhet Regjistrimi Fillestar i Pyjeve dhe Kullotave në emër të Bashkisë Patos dhe me shkresën nr.37 prot. datë 15.12.2020 i është drejtuar Bashkisë Patos, për dijëni Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit mbi òRegjistrimin Fillestar të Pyjeve dhe Kullotaveò të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me anë të VKM Nr.684 datë 02.09.2020.

Ministria Turizmit dhe Mjedisit me shkresë nr.5710 prot. datë 10.08.2021 i drejtohet Bashkisë Patos për të përshpejtuar miratimin e produktit përfundimtar të regjistrimit të pasurive Pyje dhe Kullota në administrim/pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, nëpërmjet Drejtorisë Vendore ASHK Fier. Bashkia Patos me shkresën nr.2048/1 prot. datë 13.08.2021 i drejtohet Drejtorisë Vendore ASHK Fier për të përshpejtuar regjistrimin. Për këtë u njoftua Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2048/3 prot. datë 26.08.2021.

Bashkia Patos me shkresë nr. 391 datë 03.02.2022 ka kërkuar informacion A.... O.....& D...., Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorisë Vendore të ASHK Fier se në çfarë faze është procesi dhe kur do të filloj certifikimi i pronave Pyje dhe Kullota. Përgjigja e Drejtorisë Vendore të

ASHK Fier.

Për sa argumentuam me lartë Bashkia Patos është në proces regjistrimi të pronave të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyje dhe kullota publike ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020.

- *Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Qarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2021*

Bashkia Patos për periudhën raportuese ushtrimore 2021, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 131 datë 21.10.2020 *“Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Patos dhe njërive Administrative Rruzhdie dhe Zharëzë dhe me urdhrin nr. 132 datë 21.10.2021 është krijuar Komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e asetëve Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik duke evidentuar materiale të dëmtuara respektivisht:*

- Llogaria 214 *“Instalime teknike, makineri e pajisje të dala jashtë përdorimit në vlerën 100,900 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).*
- Llogaria 218 *“Inventar Ekonomikë të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,072,655 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).*
- Llogaria 218/1 *“Inventar Ekonomik, pajisje informatike të dala jashtë përdorimit në vlerën 671,440 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).*
- Llogaria 327/1 *“Inventar i Imëtë të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,398,093 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).*

Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur procedurat sa më poshtë vijon:

Urdhri 132 datë 21.10.2021	Kryetari ka ngritur Komisionin e vlerësimit të Aktiveve të Bashkisë Patos
Shkresa nr. 2711/1 prot datë 31.12.2021.	Relacion shoqërues i inventarizimit dhe vlerësimit të materialeve të inventarizimit të Aseteve të Bashkisë Patos + Njësit Administrative Zharëz dhe Rruzhdie.
Shkresa nr. 2710/8 prot datë 14.04.2022.	Informacion Këshillit Bashkiak mbi nxjerrjen jashtë përdorimi të materialeve të inventarit viti 2021.
Vendimi nr. 43 datë 14.04.2022	Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit viti 2021
Urdhri nr. 83 datë 17.05.2022	Për ngritjen e komisionit të Asgjësimit
Në vazhdim procesi i asgjësimit	Në vazhdim procesi i asgjësimit

Referuar të dhënave të inventarëve në fund të vitit 2021 dhe pasqyrave financiare dërguar në Degën e Thesarit Fier me shkresën nr. 614 prot datë 25.02.2022 u konstatua se gjendja kontabël përputhet me gjendjen fizike si dhe përsa i përket materialeve të cilat janë nxjerr jashtë përdorimit janë të pasqyruar në bilancin kontabël pasi janë në proces asgjësimi. Veprimet janë në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollinë i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare, pika (1), neni (7) “Inventari aktiveve e detyrimeve; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,*

Në analizë: Në formatin nr. 2 ÷ Pasqyra e performancës financiare ÷ paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF formati nr. 2 e analizuar sipas aneksit nr. 12 bashkëlidhur Projekt raportit të auditimit.

Konstatohet se sipas kësaj pasqyre paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2021 (grant) në shumën **511,218,830 lekë**. Të ardhurat e realizuara nga kjo njësi vendore në vlerën 129,982,447 lekë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Fier. Përfshirja në këtë format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashtë sipas ditarit të azhurnuar nga drejtoria e taksave e tarifave vendore. Gjendja e secilës llogari të të ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura në llogaritë analitike të aktit të rakordimit me degën e thesarit Fier

Për vitin 2021 totali i të ardhurave në vlerë është 872,463,447 lekë dhe totali shpenzimeve është 633,912,551 lekë. Diferenca e tyre në vlerën **238,550,896 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”**.

- Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë.

Bashkia Patos për vitet 2021 ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë, për ti dhënë një pamje të strukturuar të informacionit kontabël të periudhës raportuese për aktivet, detyrimet, aktivet neto, fondet neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fluksin e mjeteve monetare konfirmuar me shkresën nr.1301/2 prot datë 31.05.2022. Pasqyrat e konsoliduara në nivel të vetëqeverisjes vendore me të gjitha njësitë e varësisë janë brenda afatit ligjor. **Në vartësi të Bashkisë Patos janë katër Njësi vartëse.** Pasqyrat e pozicionit financiar për periudhën e vitit 2021, të Njësive ekonomike në vartësi të Bashkisë Patos, janë dorëzuar në degën e Thesarit Fier brenda afateve ligjore. Veprimet janë në respektim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ÷ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollitë; neni 9, pika 4, germa ÷ d, neni 12 pika 2. germa ÷ b. Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ÷ Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollitë, neni 9, pika 4, germa ÷ d dhe neni 12, pika 2, germa ÷ b. UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli II, pikat 98; 99; 100; 101, germa ÷ b, pika 118.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020-2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është **2,772,347,827 lekë** dhe për vitin 2020 është **2,498,642,153 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas **Aneksit nr. 13** bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

❖ **Aktivet afatshkurtra** në vlerën prej 369,105,874 lekë dhe konkretisht:

1. Disponibilitete në thesar në vlerën 268,943,234 lekë.
2. Gjendje Inventari qarkullues në vlerën 36,245,071 lekë.
3. Llogari të arkëtueshme në vlerën 63,917,569 lekë.

❖ **Aktivet afatgjata** në vlerën prej 2,403,241,953 lekë dhe konkretisht:

1. A. Afatgjata jomateriale(studim /Kërkim) në vlerën 889,313 lekë
2. A. Afatgjata materiale (toka/troje/terrene) në vlerën 105,703,065 lekë
3. A. Afatgjata materiale (pyje /plantacione) në vlerën 2,634,900 lekë
4. A. Afatgjata materiale (Ndërtesa/konstruks) në vlerën 638,488,480 lekë
5. A. Afatgjata materiale (Rruge, rrjete) në vlerën 1,226,575,766 lekë
6. A. Afatgjata materiale (makineri e pajisje) në vlerën 18,433,117 lekë
7. A. Afatgjata materiale (Mjete transporti) në vlerën 23,069,951 lekë
8. A. Afatgjata materiale (Inventari ekonomik) në vlerën 51,343,310 lekë
9. Investimet të cilat janë akoma në proces në vlerë. 336,104,051 lekë

Në mënyrë të detajuar aktivet afatgjata sipas llogarive përkatëse janë të analizuar sipas Aneksit nr. 14 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

b).Pasivet total në vlerën 2,772,347,827 lekë si më poshtë:

❖ **Pasivet afatshkurtra** në vlerën prej 94,309,869 lekë dhe konkretisht:

1. Furnitor e llogari të lidhura me to në vlerën 29,687,724 lekë
2. Detyrime ndaj personelit në vlerën 13,371,486 lekë
3. Detyrime ndaj shtetit tatim taksa në vlerën 593,267 lekë
4. Sigurime shoqërore në vlerën 3,995,892 lekë
5. Sigurime shëndetësore në vlerën 582,014 lekë
6. Kreditore për mjete në ruajtje në vlerën 28,878,323 lekë
7. Operacione me shtetin (detyrime) në vlerën 14,297,594 lekë
8. Kreditore te ndryshëm në vlerën 1,208,804 leke

❖ **Fondi i konsoliduar** në vlerën prej 2,430,277,165 lekë dhe konkretisht:

1. Teprica (fondi i akumuluar) në vlerën 2,071,928,269 leke
2. Rezultati i veprimtarisë ushtrimore në vlerën 172,121,440 leke
3. Teprica e granteve kapitale te brendshme në vlerën.186,227,456 leke

Në formatin F2 ÷Pasqyra e Konsoliduar e Performancës Vendoreë, paraqiten të ardhurat e ushtrimit në vlerën prej 877,569,271 lekë, dhe shpenzimet e vitit ushtrimor në vlerën 705,447,831,lekë. Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor është në vlerën 172,121,440 lekë.

Në formatin F3 ÷Pasqyra e Flukseve Monetare(CASH÷FLOW)ë, paraqiten teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor në vlerën 200,999,763 lekë.

Në formatin F4 ÷Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne aktivet neto/fondet netoë ne fillim te vitit ushtrimor ka gene 2,010,134,744 leke, ndërsa ne fund te vitit 2021 fondet neto jane ne vlerën 2,430,277,165 leke.

Janë paraqitur të gjitha detyrimet që kanë ngelur nga viti ushtrimor dhe detyrimet që janë likujduar nga viti paraardhës, të mbetura në fund të vitit si; paga, sigurime shoqërore, ujë , energji elektrike, telefon, posta etj, te cilat janë në vlerën 25,189,069 lekë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llog. 468 *Debitore të ndryshëm*, për vitin 2020 paraqitet në vlerën **14,297,594 lekë** dhe në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën **14,298,576 lekë**, e cila përfaqëson detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Nga analiza e llogarisë u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë koordinuar punën ndërmjet tyre mbi pasqyrimin e gjendjes debitore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentëfamiljar për vlerën **136,906,723 lekë**, gjendje 31.12.2021. Pra kemi një nënvlerësim të llog. 468 *Debitore të ndryshëm* në vlerën **136,906,723 lekë**, veprime në kundërshtim me Udhëzimit të MF nr. 05, datë 21.2.2022 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme", aneksi 1, pika 3.3; urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar" dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 8 "Të ardhurat", pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 13-28 të Raport Auditimit)

1.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të papaguara për të detyrimeve për taksa/tarifa vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë deri më 31.12.2021 në vlerën **136,906,723 lekë**, sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezulton se sipas të dhënave të QKB, Bashkia Patos paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të òU.....ö ShA me NUIS òJ63.....B dhe numër aksionesh 1,000 me vlerë nominale 14,530 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 14,530,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në Pjesëmarrje të Bashkisë Patos në òU....ö ShA. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të pasqyrave financiare të viteve 2020 dhe 2021, më konkretisht në llog. 26 *Pjesëmarrje në kapitalet e veta*ö, veprime në kundërshtim me Urdhrin e Ministrin nr. 64 datë 22.07.2014 *Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*ö me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 *Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jomateriale*ö pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 *Trajtimi kontabël i investimeve në Pjesëmarrje*ö Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivitet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në Pjesëmarrje me vlerë kontabël **14,530,000lekë** përbën shtrembërim të informacionit financiar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 13-28 të Raport Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek òU.....ö ShA me vlerë 14,530,000 lekë, në debi të llog. 26 *Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

3. Gjetje nga auditimi. Llog. 466 *Kreditorë për mjete në ruajtje*ö, më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 28,878,324 lekë, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,392,300 lekë, për 41 subjekte të cilat përfaqësojnë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në

objekte të ndryshme. Gjatë vitit 2021 shesta janë në vlerën 10,775,298 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 9,261,321 lekë për 12 subjekte. Nga analiza e llogarisë u konstatua se për 26 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga bashkia, në vlerën 4,186,584 lekë të garancisë së punimeve sipas aneksit nr.11, pika 3, bashkangjitur Raport Auditimit nuk është bërë likuidimi i vlerës së mësipërme të garancisë, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit.

Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likuidimin e këtyre fondeve, si dhe nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, në rastet kur në objekt janë konstatuar parregullsi të cilat nuk janë riparuar nga kontraktori, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 05, datë 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 13-28 të Raport Auditimit)

3.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftoj subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

Brenda datës 31.12.2022

B. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, *nuk rekomandohet dhënia e masë disiplinore*, pasi masat janë ezauruar në auditimin e kryer për të njëjtën periudhë, sipas programit të auditimit nr. 51/1, datë 18.01.2022, të shprehura në **Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 70 datë 16.05.2022**

V. ANEKSET

Aneksi nr.2, pika 3 òPër detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë Patos viti 2021ò

Nr.	Subjekti debitor Juridik/Fizik	Urdh. zhdëmtimi		Vend. Gjyk. Formës Prërë		Vlera Lekë	Përmbajtja e debisë. Përshkrimi
		Nr.	Datë	Nr.	Datë		
1	Çerdhe					32,902	Cerdhja me ushqim(kuota ushqimore te femijeve)
